Femra nuk duhet të ndërmarrë udhëtim dyditor pa burrin e saj apo pa një mashkull të familjes

Nga Ebu Seid Hudriu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili pati marrë pjesë në dymbëdhjetë beteja me Pejgamberin e Allahut (paqja qoftë mbi të!), përcillet se ka thënë që kam dëgjuar nga Pejgamberi i Allahut (paqja qoftë mbi të!) katër gjëra, që më kanë bërë përshtypje të veçantë: "Femra nuk duhet të ndërmarrë udhëtim dyditor pa burrin e saj apo pa një mashkull të familjes. Nuk lejohet të agjërohet në këto dy ditë: dita e festës së fitrit dhe dita e festës së kurbanit. Nuk lejohet të falet namaz pas namazit të sabahut, derisa të lindë dielli e as pas namazit të ikindisë, derisa të perëndojë dielli. Dhe nuk bën të ndërmerret udhëtim i gjatë vetëm se për te këto tri xhami: Xhamia e Shenjtë, Xhamia e Aksasë dhe Xhamia ime".

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Në këtë hadith, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të!) ka ndaluar nga katër gjëra: 1. Gruaja e ka të ndaluar të ndërmarrë një udhëtim dyditor pa burrin e saj apo pa dikë nga familjarët e saj, nga ata të cilët e kanë të ndaluar kategorikisht të martohen me të, si: i biri, i ati, djali i vëllait, djali i motrës, xhaxhai, daja etj. 2. E ka bërë të ndaluar agjërimin e ditës së festës të fitrit dhe të ditës së festës të kurbanit, qoftë agjërim zotimi, vullnetar apo shpagimi. 3. E ka ndaluar namazin vullnetar pas namazit të ikindisë, derisa të perëndojë dielli dhe pasi të agojë, derisa të lindë dielli. 4. E ka ndaluar që të ndërmerret udhëtim i gjatë drejt një vendi, duke besuar se ai ka një mirësi të veçantë apo se shpërblimi në të është shumëfish, përveç këtyre tri xhamive; Xhamia e Shenjtë, Xhamia e Pejgamberit dhe Xhamia e Aksasë. Kësisoj, nuk ndërmerret udhëtim i gjatë drejt vendeve të tjera për t'u falur në to, veç këtyre tri xhamive, ngase vetëm në këto tri xhami shumëfishohet shpërblimi.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/10603